




MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të



**Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 –në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”**

dhe

Kuvendit Komunal të Vushtrrisë në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna e Vushtrrisë”

I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Vushtrrisë.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-se dhe “Komunës së Vushtrrisë” gjatë vitit 2021, bazuar në zbatimin e projektit **“Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit”** financuar nga CFD dhe zbatuar nga IADK, ndërsa projekti do të ketë shtrirje në Komunën e Vushtrrisë, Lipjanit, Shtimes dhe Mitrovicës.

Palët e lart cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e IADK-së në zbatimin e projektit

- IADK do të organizoi një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- IADK do të organizoi njëzet (20) ditë trajnime në përpunimin e frutave, perimeve apo produkteve të qumështit për 12 gra të cilat do të përzgjedhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në projekt;
- Përkrahja me një (1) njësi për përpunim e pemëve, perimeve apo qumështit në vlerë prej 7,000 euro, për kandidaten më të suksesshme e cila plotëson kriteret e selektimit;



- IADK do të organizoi vizitë 1-ditore në Kosovë, për të gjitha gratë që kanë përcjellë trajnimet;
- IADK do të organizoi pesë (5) ditë trajnime intensive dhe praktik për përgatitjen e planit të biznesit, menaxhimin e fermave dhe teknikat e prodhimit për grupin prej 15 të rinjëve cilët do të përzgjedhen në bazë të kritereve të përcaktuara në projekt;
- Përkrahja e nëntë (9) të rinjëve më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit. Paketa e granteve është e hapur, prandaj të rinjtë do të aplikojnë me idetë e tyre në vlerë 2,500euro;
- IADK do të organizoi vizitë 1-ditore në Kosovë, për të gjithë të rinjtë që kanë përcjellur trajnimet;
- IADK në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Komuna e Vushtrrisë do të bëjë përzgjedhjen e përfituesëve të granteve dhe njësisë për përpunimin e pemëve, perimeve apo qumështit;
- IADK do të furnizojë me të mira të nevojshme përfituesit e projektit;
- IADK do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetin e “Përfituesve”;
- IADK do të organizojë këshilla direkte për përfituesit e grantit, për të përgatitur dhe menaxhuar sa më mirë punët rreth aktiviteteve të tyre bujqësore;
- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim rural të Komunës së Vushtrrisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesëve;
- IADK do të ofrojë dy ditë trajnim në temat mbi të drejtat e njeriut, vendimmarrje, avokim dhe metodat e lobimit drejt institucioneve publike për pjesëmarrësit e trajnimeve për përpunim;
- IADK do të organizojë tryezë të rrumbullakët për të siguruar udhëzime në fuqizimin e grave dhe të rejave nga zonat rurale duke rritur mundësinë e qasjes në tregun e punës dhe gjenerimin e të ardhurave, zyrtarë nga MBPZHR, zyrtarë të Barazisë Gjimore nga niveli lokal dhe qendror, Ministria e Pushtetit Lokal, Zyra e Punësimit Publik, komunat, ministritë e tjera përkatëse dhe përfituesit e projektit;

III. Obligimet e “Komunës së Vushtrrisë” në përkrahjen e zbatimit të projektit

- “Komuna e Vushtrrisë” dhe “IADK”-ja pajtohen që të përkrahin njëra-tjetrën në zbatimin e projektit në interes të “Komunës së Vushtrrisë” dhe “IADK”-së dhe të cilat zbatohen në “Komunën e Vushtrrisë”;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të përkrahë “IADK”-në në bashkëfinancimin e projektit;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të bashkëfinancojë projektin të përfituesit e granteve për të rinjtë dhe të njësisë përpunuese me 20 % të investimit (shih tabelen 1);
- “Komuna e Vushtrrisë” së bashku me “IADK” do të organizojë sesionet informuese, duke informuar shoqatat, fermerët, grave dhe të rinjtë të regjistruara në databazën e komunës;
- “Komuna e Vushtrrisë” do t’i ndihmojë “IADK”-së në organizimin e grupeve për trajnimet në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit;

Adresa:


Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

*Është jelojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



- “Komuna e Vushtrrisë” do të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të granteve dhe njësisë përpunuese;
- “Komuna e Vushtrrisë” mund të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e “Përfituesëve” edhe pas përfundimit të projektit;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të asistojë IADK-në në organizimin e tryezave të rumbullakta dhe caktojë personin, i cili do jetë pjesë e panelit si përfaqësues i Komunës së Vushtrrisë.

Tabela 1 Komuna Vushtrri -Bashkëfinancimi i projektit për vitin 2021

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesëve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna	Përfituesit
1	Përkrahje e të rinjëve me grante në sektorin e bujqësisë	Fermer	9	2,500.00	22,500.00	15,750.00	4,500.00	2,250.00
2	Ngritja e Njesisë përpunuese (pemëve, perimeve apo qumështit)	Fermer	1	7,000.00	7,000.00	4,900.00	1,400.00	700.00
Total direkte					29,500.00	20,650.00	5,900.00	2,950.00
3	Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte , trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontrates me përfitues				8,850.00	7,080.00	1,770.00	-
Buxheti total					38,350.00	27,730.00	7,670.00	2,950.00
						IADK	Komuna	Fermeri
						72%	20%	8%
Investimi total në Komunë								38,350.00

IV. Mënyra e pagesës së bashkëfinancimit nga Komuna e Vushtrrisë

- “Komuna e Vushtrrisë” do t’i bëjë pagesën IADK-së për bashkëfinancim gjatë vitit 2021, pas zbatimit të projekteve dhe dorëzimit të raportit final për mbështetjen e lartë cekur, listën e përfituesve dhe kërkesës për pagesë, nga ana e IADK-së;
- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në **Nr.xhir:2027-000021-7128-84**, në emër të IADK-së;
- Te pika 1, numri i përfituesve të granteve është tentativë, dhe mund të rritet ose zvogëlohet varsishte nga intersimi i kandidatëve dhe plotësimi i kriterëve të përcaktuara me projekt;
- Te pika 2, numri i njësisë përpunuese është tentativë, dhe mund të rritet edhe për një njësi përpunuese, varsishte nga zhvillimi i projektit;
- Varësisht nga numri i përfituesve dhe vlera e investimit në Komunën e Vushtrrisë, do të bëhet edhe bashkëfinancimi (por nuk do të kalojë vlerën 20% nga investimi total nga Komuna e Vushtrrisë).

Adresa:


Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

*Është jetojmë nga loka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



- Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë, poashtu kontratat me përfituesit e projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi);

V Përgjegjësit të tjera

- “IADK” do të njoftoj në mënyrë të rregullt dhe do të raportoj në fund të projektit tek “Komuna e Vushtrrisë” për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të MpB;
- “IADK” do të njoftoj me kohë “Komunën e Vushtrrisë” për mundësinë e vazhdimit të MpB për vitin 2022;

VI Personat Kontaktues

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshihen drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB. “IADK” do të përfaqësohet nga Znj. Hafize Veseli ndërsa “Komuna e Vushtrrisë” do të përfaqësohet nga Rabije Zahiti.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga muaji Mars 2021 deri në muajin Dhjetor 2021, dhe hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.


VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 02/05/ 2021



Komuna e Vushtrrisë

Xhafer Tahiri
Kryetari i Komunës

Vushtrri _____ 2021